



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:218199

Datë: 29.04.2024

Numri i dokumentit: 05637047

KPPP.nr.1658/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit “LEXALO” Sh.P.K., me seli në Lipjan, rruga “Ibrahim Rugova”, me NUI: 810711342, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat Jeton Idrizi me seli të zyrës në Prishtinë, kundër debitorit “Trepça” Sh.A., me adresë Parku Industrial në Mitrovicë, me NUI: 811278747, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.409/2023 të datës 25.09.2023, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Fadil Hoxha me seli të zyrës në Prishtinë, jashtë seancës me datë 17.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET NË TËRËSI i pabazuar prapësimi i debitorit “Trepça” Sh.A., i paraqitur kundër Urdhrit P.nr.409/2023 të datës 25.09.2023, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Fadil Hoxha, dhe i njëjti Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.

- II. Detyrohet debitori që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktvendimi t’ia paguaj kreditorit shpenzimet e procedurës në këtë gjykatë sipas prapësimin të debitorit në shumë të përgjithshme prej 208 €, në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim nga avokati.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, me Urdhrin Përmbarimor P.nr.409/2023 të datës 25.09.2023, e ka caktuar përmbarimin ndaj debitorit në bazë të dokumenteve të besueshme—faturave dhe atë: faturës nr.1530 të datës 21.06.2021, dhe faturës nr.2349 të datës 16.11.2022, duke urdhëruar debitorin që për faturën nr.1530 të datës 21.06.2021 t’ia paguajë kreditorit shumën e borxhit në vlerë prej 990.00 Euro, ndërsa për faturën nr.2349 të datës 16.11.2022 t’ia paguajë shumën e borxhit në vlerë prej 22,891.85, me kamatë vjetore në lartësi prej 8 % duke filluar nga data e arritjes për pagesë të secilës faturë, si dhe shpenzimet e procedurës së përmbarimit, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër urdhrin të Përmbaruesit Privat, brenda afatit të rregullt ligjor debitori ka ushtruar prapësim, me arsyetimin se dokumenti në bazë të së cilit është bërë propozimi ose urdhri përmbarues nuk është dorëzuar në original apo kopje të vërtetuar. Po ashtu debitori e ka kundërshtuar urdhrin për përmbarim edhe për faktin se urdhri nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së. I ka propozuar gjykatës që ta hedhë poshtë urdhrin për përmbarim P.nr.409/2023 të datës 25.09.2023.

Kreditori në përgjigje në prapësim, ka theksuar se së bashku me propozim janë bashkangjitur të gjitha faturat, respektivisht kopje e vërtetuar e origjinalit, konform nenit 37 të LPP-së, të cilat janë pranuar nga debitori, të njejtat janë nënshkruar dhe janë dokument i besueshëm. Kreditori ka shtuar se disa herë ka tentuar ta bind debitorin t’i paguaj borxhet sipas faturave, por i njejtë gjithmonë ka theksuar se do t’i paguajë shumë shpejtë, por vetëm pjesërisht e ka përmbushur obligimin për faturën nr.2349 në shumën prej 15,000.00 Euro, duke mbetur borxh edhe shumën prej 22,891.85 Euro, ndërsa faturën nr.1530 debitori nuk e ka paguar fare. I ka propozuar gjykatës që prapësimi të refuzohet si i pabazuar, ndërsa ta lë në fuqi urdhrin për përmbarim të Përmbaruesit Privat, si dhe i ka kërkuar shpenzimet për përgjigje në prapësim në shumën prej 416 Euro sipas Tarifës së Avokatëve të Kosovës numri tarifor 6 lidhur me numrin tarifor 9.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, deklarimeve në përgjigje në prapësim të kreditorit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori i kishte lëshuar debitorit faturën nr.1530 të datës 21.06.2021 në shumën prej 990.00 Euro, dhe faturën nr.2349 të datës 16.11.2022 në shumën prej 37,891.85 Euro. Debitori ka arritur që të bëjë pagesën e pjesshme të borxhit që rrjedh nga fatura nr.2349 në shumën prej 15,000.00 Euro, ndërsa borxhi i mbetur nga kjo faturë është në shumën prej 22,891.85 Euro, fakt ky i cili vërtetohet në propozimin për përmbarim nga vet kreditori.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura përmbajnë të gjitha elementet të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37, dhe rrjedhimisht i plotësojnë për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, të njëjtat janë dorëzuar në kopje të vërtetuar sipas ligjit, si dhe janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt i cili vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit në këto fatura.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 452 par. 1 dhe 463 par.1 dhe 2 të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së. Gjykata e gjeti si të bazuar kërkesën e kreditorit për pagesë të shpenzimeve sa i përket përpilimit të përgjigjes në prapësim, ndërsa lartësinë e saj

gjkata e llogariti duke u bazuar në Rregulloren për Tarifën e Odës së Avokatëve të nxjerrë nga Oda e Avokatëve më 18 mars 2017, siç përcakton neni 453 par.2 LPK-së lidhur me nenin 13 dhe 17 të LPP-së, ashtu që si bazë u mor lartësia e vlerës së përmbartimit, numri i palëve të përfaqësuar, si dhe lloji i veprimit procedural për të cilin janë kërkuar shpenzimet.

Nga sa u theksua më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit gjykata ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1658/23, me datë 17.04.2024

Gj y q t a r i
Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.